

AFATE DHE KUSHTE TË PËRGJITHSHME TË KONTRATËS SË QIRASË FINANCIARE

Afatet dhe Kushtet e Përgjithshme (më poshtë referuar “AKP”) janë pjesë përbërëse e Kontratës së Qirasë së lidhur midis Qiradhënësit Porsche Leasing Shpk., dhe Qiramarrësit si dhe janë në përputhje me ligjin nr. 9396 datë 12.05.2005 “Për qiranë financiare” i ndryshuar (më poshtë referuar “Ligji për Qiranë Financiare”) si dhe me legjislacionin shqiptar të zbatueshëm në Shqipëri që rregullon aktivitetin e qirasë financiare. Termat e përcaktuar në këto Afate dhe Kushte të Përgjithshme kanë të njëjtin kuptim me termat e referuar në Kontratën e Qirasë Financiare përveç nëse është përcaktuar ndryshe. Kontrata e Qirasë Financiare, Afatet dhe Kushtet e Përgjithshme dhe të Veçanta të Qirasë Financiare, Plani i Pagesave, Procesverbali për Dorëzimin dhe Pranimin e Objektit të Qirasë Financiare, Lista e Çmimeve të Qiradhënësit për shërbimet, polica për sigurim të detyrueshëm kundrejt përgjegjësisë dhe sigurimi Casco si dhe të gjitha ndryshimet dhe shtesat e mëtejshme do të jenë të vlefshme vetëm nëse janë kryer me shkrim dhe nënshkruar nga palët, përveç nëse është parashikuar ndryshe në Afatet dhe Kushtet e Përgjithshme dhe në Kontratën e Qirasë Financiare.

PËRKUFIZIME

Qiradhënësi - do të thotë Porsche Leasing Shpk., një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit me datë 23.04.2013 me numër identifikimi (NIPT) L31623006N, me seli të ndodhur në adresën: Autostrada Tiranë-Durrës, Km 3, Mëzez, Tiranë Shqipëri. Qiradhënësi zotëron dhe ruan të drejtën të zotërojë titullin e pronësisë mbi Objektin e Qirasë Financiare dhe i jep Qiramarrësit të drejtën të mbajë dhe të përdorë Objektin e Qirasë Financiare përgjatë gjithë afatit dhe kohëzgjatjes së Kontratës së Qirasë Financiare.

Qiramarrësi - do të thotë një personi fizik ose juridik, të përcaktuar në Kontratën e Qirasë Financiare, i cili mund të fitojë të drejtën e pronësisë mbi Objektin e Qirasë Financiare, pasi ka mbajtur në përdorim atë gjatë gjithë afatit të Kontratës së Qirasë Financiare dhe pasi ka shlyer të gjitha pagesat e qirasë financiare si dhe çmimin përfundimtar të blerjes.

Objekti i Qirasë Financiare - do të thotë çdo automjet, pajisje, mekanizëm ose çdo send tjetër i luajtshëm i cili është objekt i Kontratës së Qirasë Financiare.

Kontrata e Qirasë Financiare - do të thotë kontrata e qirasë financiare që lidhur midis Qiradhënësit dhe Qiramarrësit për përdorimin e objektit të qirasë për një afat, sa pjesa më e madhe e afatit të konsumimit të Objektit të Qirasë Financiare, përkundrejt pagesave periodike, shuma e të cilave është sa vlera reale në treg e Objektit të Qirasë Financiare, por që arrin të mbulojë investimin e Qiradhënësit dhe të sigurojë një fitim mbi investimin.

Pagesat/Këstet e Qirasë Financiare - do të thotë pagesat periodike që do të kryhen nga Qiramarrësi gjatë gjithë vlefshmërisë dhe kohëzgjatjes së Kontratës së Qirasë Financiare në përputhje me afatet dhe kushtet e parashikuara në Kontratën e Qirasë Financiare dhe në këto AKP.

Dorëzuesi - do të thotë një person fizik ose juridik i regjistruar dhe i autorizuar për të prodhuar, tregtuar apo riparuar/mirëmbajë Objektin e Qirasë Financiare, i cili i transferon Qiradhënësit të drejtën e tij të pronësisë mbi Objektin e Qirasë Financiare, me qëllim dorëzimin e Objektit të Qirasë Financiare tek Qiramarrësi për mbajtje dhe përdorim nga ky i fundit.

1. PRONËSIA / NDALIMI I TRANSFERIMIT TË AUTORIZIMIT

- 1.1 Gjatë gjithë kohëzgjatjes së Kontratës së Qirasë Financiare, Qiradhënësi, do të jetë pronari ekskluziv i Objektit të Qirasë Financiare, ndërkohë që Qiramarrësi në përputhje me Kontratën e Qirasë Financiare, nuk do të fitojë titullin e pronësisë apo ndonjë të drejtë tjetër ekskluzive

mbi Objektin e Qirasë Financiare, por vetëm të drejtën e përdorimit të Objektit të Qirasë Financiare.

- 1.2 Në rast të të ardhurave të arkëtueshme monetare apo jo-monetare të mundshme, kundrejt Qiradhënësit, Qiramarrësi nuk do të ketë të drejtë të mbajë Objektin e Qirasë Financiare, pavarësisht llojit të marredhënies dhe shkaqeve të gjenerimit të të ardhurave të arkëtueshme.
- 1.3 Qiramarrësi nuk mund të disponojë Objektin e Qirasë Financiare, ta ngarkojë atë me pengje apo ta japë atë me nën-qira. Qiramarrësi është shprehimisht i ndaluar të kryejë veprimet e mëposhtme përmes çfarëdolloj veprimi ligjor apo veprimi tjetër të çfarëdo lloji:
 - (i) Të disponojë Objektin e Qirasë Financiare;
 - (ii) Të japë në përdorim Objektin e Qirasë Financiare tek palë të treta të cilat nuk janë të përcaktuara në listën e përdoruesve të cilet nuk janë të kualifikuar për përdorimin e tij dhe të cilët nuk kanë marrë miratimin paraprak me shkrim të Qiramarrësit;
 - (iii) Të japë me nën-qira Objektin e Qirasë Financiare ose të lejojë që Objekti i Qirasë Financiare të përdoret për kryerje të shërbimeve të qiradhënies së automjeteve, auto-shkolle ose çfarëdo lloj tjetër veprimtarie tregtare, përveç nëse veprimtaria e tillë është përcaktuar shprehimisht në Kontratën e Qirasë Financiare;
 - (iv) Të lidhë, përsa i përket Objektit të Qirasë Financiare, marrëveshje bashkëpunimi, marrëveshje franchise apo marrëveshje të ngjashme sipas të cilave palë të treta fitojnë në çfarëdolloj forme të drejtën për të përdorur drejtpërdrejt Objektin e Qirasë Financiare, pavarësisht nëse një e drejtë e tillë është transferuar tek palë të treta apo përmes marrëveshjes;
 - (v) Të ngarkojë apo kufizojë Objektin e Qirasë Financiare me barrë;
 - (vi) Të rrezikojë apo shkelë në çfarëdolloj mënyrë të drejtën e pronësisë dhe posedimin e drejtpërdrejtë të Qiradhënësit mbi Objektin e Qirasë Financiare.
- 1.4 Në rast të shkeljes së parashikimeve të përcaktuara në paragrafin këtu më sipër, Qiradhënësi do të ketë të drejtë të zgjidhë Kontratën e Qirasë Financiare dhe do të autorizohet të:
 - a) aktivizojë instrumentet e garancisë së pagesave për të gjithë shumën e të gjitha kësteve të Qirasë Financiare pavarësisht maturimit të tyre, nëse është rënë dakord se pas pagesës së të gjithë shumës (kryegjësë, interesave, kostove), Qiramarrësi do të bëhet pronari i ligjshëm i Objektit të Qirasë Financiare; ose
 - b) përpara përfundimit të afatit të Kontratës së Qirasë Financiare, të njoftojë Qiramarrësin se Kontrata e Qirasë Financiare ka përfunduar në përputhje me parashikimet e ligjit të zbatueshëm dhe të kërkojë kthimin e Objektit të Qirasë Financiare, që do të thotë sekuestrimi i Objektit të Qirasë Financiare.
- 1.5 Qiramarrësi merr përsipër të mbajë dhe paraqesë Objektin e Qirasë Financiare të ndarë nga asetet e tij dhe të percaktojë se Objekti i Qirasë Financiare është në pronësi të Qiradhënësit.
- 1.6 Qiramarrësi do të njoftojë Qiradhënësin lidhur me çdo fakt apo veprim të një pale të tretë kundrejt Objektit të Qirasë Financiare apo propozimit për ekzekutim të pasurive të luajtshme të Qiramarrësit të paraqitur nga çdo palë, si për shëmbull, sekuestrimi, konfiskimi, etj. Qiramarrësi është i autorizuar si dhe duhet të marrë të gjitha veprimet dhe masat e nevojshme me qëllim mbrojtjen e pasurisë së Qiradhënësit edhe nëse ai duhet të mbartë kosto të caktuara për këtë qëllim. Qiradhënësi duhet të rimbursojnë qiramarrësin lidhur me të gjitha kostot e lindura në këtë rast brenda 8 (tetë) ditësh nga marrja e vërtetimit lidhur me kostot.
- 1.7 Qiramarrësi merr përsipër, në rast të fillimit të procedurave të falimentimit ose likuidimit, të njoftojë menjëherë Qiradhënësin lidhur me këtë dhe Qiradhënësi do të ketë të drejtë të kërkojë menjëherë kthimin e Objektit të Qirasë Financiare pa mbajtur asnjë përgjegjësi për përfundimin e Kontratës së Qirasë Financiare si dhe marrjen e Objektit të Qirasë Financiare. Qiramarrësi merr përsipër gjithashtu të njoftojë marrësin ose administratorin lidhur me pronësinë e Qiradhënësit mbi Objektin e Qirasë Financiare.
- 1.8 Qiradhënësi është i autorizuar që të vendosë, në mënyrën e përcaktuar prej tij, një shenjë të

dukshme mbi Objektin të Qirasë Financiare e cila do të tregojë se Qiradhënësi është pronari i Objektin të Qirasë Financiare. Nëse, rregullore apo ligje të miratuara pas hyrjes në fuqi të Kontratës së Qirasë Financiare, do të parashikojnë një formë detyruese për shënimin e Objektin të Qirasë Financiare, Qiramarrësi do të jetë i detyruar të lejojë Qiradhënësin të kryejë këto shënime mbi Objektin të Qirasë Financiare me shpenzimet e Qiradhënësit.

- 1.9 Pas pagesës së pagueshme të Këstit të fundit të kontraktuar të Qirasë Financiare për përdorimin e Objektin të Qirasë Financiare në shumën e përcaktuar në Kontratën e Qirasë Financiare dhe në Planin e Pagesave, Qiradhënësi, mbi bazën e kërkesës së Qiramarrësit, do të transferojë të drejtën e pronësisë mbi Objektin e Qirasë Financiare, së bashku me detyrimin e Qiramarrësit që të mbartë të gjitha kostot e transferimit të kësaj të drejte pronësie, përfshirë këtu pagesën e të gjitha taksave të zbatueshme sipas legjislacionit shqiptar.

2. MARRJA NË DORËZIM E OBJEKTIT TË QIRASË FINANCIARE /GARANCITË PËR RREGULLSHMËRINË E OBJEKTIT TË QIRASË FINANCIARE

- 2.1 Qiradhënësi, duke mbajtur të drejtën e pronësisë mbi Objektin e Qirasë Financiare, do t'i transferojë Qiramarrësit të drejtën e mbajtjes dhe përdorimit të Objektin të Qirasë Financiare në kohën e duhur dhe në përputhje me tarifat e përcaktuara në Kontratën e Qirasë Financiare.
- 2.2 Qiramarrësi, merr përsiper, mbi bazën e rreziqeve dhe shpenzimeve të veta, të marrë në dorëzim Objektin e Qirasë Financiare në vendin dhe në kohën mbi të cilën është rënë dakord. Qiramarrësi do të mbartë të gjitha kostot e transportit të Objektin të Qirasë Financiare dhe sigurimit të transportit të cilat do të lindin pas marrjes nga Qiramarrësi të njoftimit lidhur me marrjen në dorëzim të Objektin të Qirasë Financiare.
- 2.3 Në momentin e dorëzimit, qiramarrësi dhe Dorëzuesi do të përgatisin një Procesverbal Dorëzimi mbi dorëzimin dhe pranimin i cili do të përfshijë përshkrimin e të gjitha defekteve/mangësive të rëndësishme të defektet/mangësitë e fshehura të rëndësishme. Pas nënshkrimit të Procesverbalit të Dorëzimit, përgjegjësia e Qiradhënësit për defektet/mangësitë e fshehura të rëndësishme do të përjashtohet. Me nënshkrimin e Procesverbalit të Dorëzimit, të gjitha të drejtat lidhur me defektet/mangësitë e fshehura të rëndësishme kundrejt Prodhuesit dhe/ose Dorëzuesit të Objektin të Qirasë Financiare do të transferohen Qiramarrësit. Prodhuesi dhe/ose Dorëzuesi i Objektin të Qirasë Financiare do të jetë ekskluzivisht përgjegjës për të gjitha defektet/mangësitë e fshehura të rëndësishme të Objektin të Qirasë Financiare dhe në këtë mënyrë Qiramarrësi do të paraqesë të gjitha pretendimet që ai mund të ketë në lidhje me defektet/mangësitë e fshehura të rëndësishme të Objektin të Qirasë Financiare (përfshire këtu kufizime, defektet/mangësitë e fshehura të rëndësishme në strukturë, prodhim dhe material), drejtpërdrejt tek prodhuesi dhe/ose dorëzuesi.
- 2.4 Qiramarrësi deklaron dhe garanton se ai do të ndërmarrë me shpenzimet dhe risqet e veta, të gjitha veprimet dhe masat e nevojshme për montimin e duhur dhe vënien në punë të Objektin të Qirasë Financiare.
- 2.5 Qiramarrësi duhet të njoftojë menjëherë Qiradhënësin lidhur me mosmarrëveshje ose pretendime të ngritura nga palë të treta në lidhje me Objektin e Qirasë Financiare, të cilat pretendojnë se kanë të drejta mbi Objektin e Qirasë Financiare, natyra e të cilës është e tillë që mund të zvogëlojë, përjashtojë apo kufizojë posedimin e pakufizuar dhe përdorimin e Qiramarrësit.

3. REGJISTRIMI I OBJEKTIT TË QIRASË FINANCIARE

- 3.1 Qiramarrësi është i detyruar të pajiset me një autorizim të posaçëm nga Qiradhënësi për kryerjen e ekzaminimit teknik të Objektin të Qirasë Financiare, pagesën e taksave dhe tarifave vjetore të aplikueshme lidhur me përdorimin e automjetit në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi si dhe për veprime të tjera të nevojshme në lidhje me to, të paktën 8 (me fjalë: tetë) ditë përpara përfundimit të afatit të vlefshmërisë së regjistrimit të Objektin të Qirasë

Financiare si edhe pas kryerjes së regjistrimit të Objektivit të Qirasë Financiare Qiramarrësi do ti dorëzojë Qiradhënësit një kopje të dokumenteve të regjistrimit të automjetit. Qiradhënësi nuk është i detyruar të leshojë autorizim të tillë në rast se Qiramarrësi ka detyrime të papaguara sipas Kontratës së Qirasë Financiare. Gjatë kohëzgjatjes së Kontratës së Qirasë Financiare, të gjitha kostot lidhur me ekzaminimin teknik të Objektivit të Qirasë Financiare, pagesa e taksave dhe tarifave vjetore të aplikueshme lidhur me përdorimin e automjetit në përputhje me legjislacionin shqiptar do ti ngarkohen Qiramarrësit. Nëse palët bien dakord, Qiradhënësi mund të paguajë të gjitha kostot e lartpërmendura dhe t'ia ngarkojë më pas këto kosto Qiramarrësit së bashku me faturën e lëshuar për këstet e qirasë financiare mujore përkatëse.

4. SIGURIMI

- 4.1 Gjatë gjithë kohëzgjatjes së Kontratës së Qirasë Financiare, Qiramarrësi, në përputhje me afatet dhe kushtet e shoqërisë së sigurimit, do të lidhë një kontratë për sigurimin e detyrueshëm të përgjegjësisë dhe sigurim plotësues për drejtuesin e automjetit dhe pasagjerët, duke mbuluar riskun nga aksidentet, vjedhja e automjetit dhe mashtrimi (kundër zjarrit, fatkeqësive natyrore, përmbytjeve, thyerjes, etj.). Kontratat e sigurimit do të jenë pjesë përbërëse e Kontratës së Qirasë Financiare.
- 4.2 Qiramarrësi do të ketë të drejtë të zgjedhë shoqërinë e sigurimit dhe formën e sigurimit me kusht që shoqëria e sigurimit dhe forma e sigurimit të pranohen nga Qiradhënësi. Gjithashtu Qiramarrësi bie dakort dhe jep pëlqimin e tij që automjeti të pajiset me GPS (Global Positioning System), pajisje që shërben për identifikimin e vendodhjes së automjetit, për qëllime të kësaj kontrate qiraje dhe/ose kontratës së sigurimit të automjetit.
- 4.3 Të gjitha kostot e sigurimit janë në ngarkim drejtpërdrejt Qiramarrësit.
- 4.4 Qiramarrësi nuk do të përdorë Objektivin e Qirasë Financiare në zona në të cilat shoqëria e sigurimit me të cilën Qiramarrësi ka nënshkruar kontratën me mbulim sigurimi full kasko, nuk e njeh këtë sigurim dhe nëse Qiramarrësi vepron në kundërshtim me këtë dispozitë, Qiramarrësi do të paguajë të gjithë shumën për dëmet e mundshme që mund ti jenë shkaktuar Qiradhënësit.

5. PAGESAT

- 5.1 Qiramarrësi merr përsipër gjatë gjithë kohëzgjatjes së Kontratës së Qirasë Financiare, ti paguajë Qiradhënësit në mënyrë periodike mujore, Këstet e kontraktuara të Qirasë Financiare për përdorimin e Objektivit të Qirasë Financiare në shumën e përcaktuar në Kontratën e Qirasë Financiare dhe në Planin e Pagesave.
- 5.2 Detyrimet monetare që rrjedhin nga Kontrata e Qirasë Financiare lidhur me qiranë financiare janë shprehur dhe do të kryhen në EURO (EUR). Qiramarrësi do të mbartë riskun e shkëmbimit të monedhës së huaj si dhe kostot e këmbimit të monedhës, në lidhje me kryerjen e pagesës së kësteve të qirasë në monedhën e financimit të përcaktuar në Kontratën e Qirasë Financiare.
- 5.3 Këstet e kontraktuara të Qirasë Financiare do të bëhen të pagueshëm në ditët dhe brënda afateve të përcaktuara në Planin e Pagesave, i cili është pjesë përbërëse e Kontratës së Qirasë Financiare. Pagesat e kryera do të përdoren për të likuiduar fillimisht faturat më të hershme dhe më pas ato të mëvonshme në përputhje me detyrimet e lindura sipas Kontratës. Çdo shumë e qirasë mujore do të paguhet nga Qiramarrësi brenda datës 15-të të çdo muaji. Përpara dorëzimit të objektivit të qirasë tek Qiramarrësi, ky i fundit do të kryejë në favor të Qiradhënësit pagesën e parë të shumës mujore të qirasë financiare për përdorimin e objektivit të qirasë.
- 5.4 Në të njëjtën ditë të arkëtimit të shumës së parë të qirasë financiare pranë Porsche Leasing Shpk, në përputhje me Kontratën e Qirasë Financiare, këto AKP, sipas shkresës informuese që do ti paraqitet Qiramarrësit, si bazuar në Ligjin nr. 92/2014 “Për TVSH në Republikën e Shqipërisë”, Neni 97, paragrafi 1, pika (b), Qiradhënësi do t'i lëshojë Qiramarrësit faturën përkatëse, e cila përveç shumës mujore të qirasë, do të përfshijë edhe shumën e tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH).

- 5.5 Këstet e Qirasë Financiare, do të paguhen në llogarinë bankare të dhënë nga Qiradhënësi. Konsiderohet si dita në të cilën është kryer pagesa, dita në të cilën kreditohet llogaria bankare e Qiradhënësit në përputhje me vlerën e pagesës përkatëse.
- 5.6 Të gjitha faturat që do të lëshohen nga Qiradhënësi, për kryerjen e pagesave të shumave përkatëse mujore të qirasë financiare për muajt në vijim në përputhje me Kontratën e Qirasë, këto AKP si dhe planit të pagesave, do të përfshijnë TVSH e aplikueshme sipas Legjislacionit Shqiptar në fuqi. Faturat tatimore të lëshuara nga Qiradhënësi dhe cdo shpenzim tjetër lidhur me këtë kontratë, janë të ekzekutueshme edhe në rastin kur Qiramarrësi nuk i ka firmosur ato. Këto fatura i vihen në dispozicion Qiramarrësit për të realizuar pagesat përkatëse pa qënë i nevojshëm nënshkrimi i tyre nga ana e këtij të fundit, i cili njih dhe i ka pranuar ato me nënshkrimin e kësaj kontrate si dhe Planit të Pagesave. Formula e llogaritjes së Kësteve të Qirasë Financiare paraqitet si më poshtë:

$$K = \frac{(\text{Ç}-P)i(1+i)^N - RVi}{(1+i)^N - 1}$$

ku:

K - Kësti mujor i Qirasë Financiare

Ç - Çmimi i Furnizimit

P - Parapagimi i qiramarrësit

i - Interesi mujor i financimit

N - Periudha e financimit e shprehur në muaj

RV - Vlera e mbetur

- 5.7 Shuma e kontraktuar e Kësteve të Qirasë Financiare do të përfshijë gjithashtu interesat, që do të shtohen qirasë mujore për përdorimin e automjetit, e cila përbën kompensimin për Qiradhënësin.
- 5.8 Nëse pas marrjes në dorëzim të Objektit të Qirasë Financiare nga Qiramarrësi, do të ketë ndryshime në normat e taksave, normat e interesit dhe pagesa të tjera, shuma e këstit mujor të qirasë do të rregullohet në përputhje me këto ndryshime. Më tej, të gjitha rrethanat e tjera të cilat mund të prekin apo ndikojnë në të drejtat dhe detyrimet e palëve si dhe të cilat nuk janë shkaktuar nga Qiradhënësi (ndryshime në rregullore, masa të autoriteteve kompetente, rritja e cmimit të shitjes së objektit të qirasë financiare pas përfundimit të nënshkrimit të Kontratës së Qirasë Financiare dhe përpara dorëzimit të Objektit të Qirasë Financiare etj) automatikisht përbën bazën për rregullimin e këstit të qirasë. Nëse ky rregullim, do të rezultonte në rritjen e këstit të qirasë me mbi 20%, të dyja Palët do të kenë të drejtën të ndërpresin marrëveshjen. Gjatë këtij rregullimi, nuk është e nevojshme të lidhet një aneks i veçantë i kontratës, pra Qiradhënësi do të informojë me shkrim Qiramarrësin për ndryshimet e sipërpërmendura.
- 5.9 Dështimi ose aftësia e kufizuar për të përdorur qiranë financiare, pavarësisht arsyes, si dhe ankimi i mundshëm i Qiramarrësit lidhur me llogaritjen mujore të këstit të qirasë financiare dhe kosto të tjera nuk do të përbëjnë arsye për mospërmblidhjen e detyrimit për të paguar këstet mujore të qirasë në momentin kur ato bëhen të pagueshme. Për të gjitha pagesat e vonuara të kësteve të qirasë financiare, Qiradhënësi, do të ngarkojë Qiramarrësin dhe do të mbledhë interesin e ligjshëm të paracaktuar, të llogaritur në vlerën ekuivalente në monedhën e huaj të këstit mujor. Këstet e qirasë të paguara paraprakisht, nuk do të rimbursohen dhe nuk do të mbartin asnjë interes.

6. INTERESI

- 6.1 Norma e interesit e aplikuar mbi qiranë financiare sipas kësaj Kontrate, mund të jetë Normë Nominale e Interesit fikse (e pandryshueshme) ose Normë Nominale e Interesit variabël (e ndryshueshme). Në rast se Norma Nominale e Interesit është variabël (e ndryshueshme), kjo e fundit, do të llogaritet për shumat e papaguara të kësteve mujore mbi bazën EURIBOR 3M, (ku EURIBOR do të thotë: Kursi i Ofruar në Tregun Ndërbankar European me maturim 3 Mujor).
- 6.2 Llogaritja e interesit kontraktor fillon nga data e dorëzimit të automjetit, sikurse përcaktohet në aktin e dorëzimit dhe do të mbarojë një ditë pune më vonë nga ripagimi i plotë i shumës së financimit, nëse vlera e mbetur është paguar ose kur objekti është kthyer mbrapsht.
- 6.3 Norma e Interesit e llogaritur për tremujorin e parë do të bazohet në normën e EURIBOR 3M të përcaktuar në datën e lidhjes së kësaj Kontrate. Në vijim Qiradhënësi, do të rregullojë normën e interesit me ndryshimet në EURIBOR 3M katër herë në vit: çdo datë 20.02. (20 shkurt), 20.05. (20 maj), 20.08. (20 gusht) dhe 20.11. (20 nëntor), vetëm nëse ka një ndryshim të EURIBOR 3M me më shumë se $\pm 0,25\%$ pikë në përqindje në raport me vlerën e EURIBOR 3M në ditën e rregullimit të mëparshëm të normës së interesit. Rregullimi i normës së interesit për shkak të ndryshimeve në EURIBOR tre mujor kryhet në përputhje me ndryshimet në normën e interesit referencë në periudhat e treguara, pa detyrimin për të lidhur një marrëveshje të veçantë.
- 6.4 Qiradhënësi do të informojë Qiramarrësin për ndryshimin e normës së interesit me shkrim (në adresën postare ose elektronike), jo më vonë se 7 ditë para datës së caktuar për pagesën e kështit të qirasë me normën e ndryshuar të interesit, me dorëzimin e planit të ripagimit të ndryshuar.
- 6.5 Qiramarrësi pajtohet që rregullimi i kështit mujor sipas ndryshimit të normës së interesit, nuk do të kryhet edhe nëse kushtet për rregullim plotësohen në përputhje me dispozitat e kontratës dhe nëse kanë mbetur më pak se 3 muaj deri në fund të periudhës së financimit.
- 6.6 Interesi do të llogaritet në bazën e një viti me treqind e gjashtëdhjetë e pesë (365) ditë, duke marrë në konsideratë: (i) shuma e pashlyer e qirasë financiare; (ii) bazën e interesit të kontraktuar për shumën e mësipërme me (iii) numrin e saktë të ditëve të periudhës përkatëse të llogaritjes, sipas formulës së mëposhtme:

$$\text{Interesi} = \frac{\text{Shuma e pashlyer} \times \text{Normë Interesi} \times \text{Numri i ditëve}}{365}$$

- 6.7 **Klauzola e ndryshimit të indeksit orientues:** Në rast se Norma e Interesit është (ndryshueshme), që do të thotë se kjo kontratë qiraje financiare ka normë e përbërë interesi nga indeksi orientues/norma bazë dhe marzhi, atëherë Qiradhënësi i lind e drejta të zëvendësojë indeksin orientues/normën bazë, vetëm nëse ndodh një ndërprerje e kuotimit të këtij indeksi orientues për monedhën e qirasë financiare. Në këtë rast Qiradhënësi, do të njoftojë klientin sipas mënyrave të parashikuara në këtë kontratë për zëvendësimin e tij me një indeks oreintues alternativ për monedhën e qirasë financiare të publikuar nga autoritet rregullatore.

7. NORMA E INTERESIT EFEKTIV (NEI)

- 7.1 Norma Efektive e Interesit (NEI) është _____ %, kjo e llogaritur në ditën e nënshkrimit të kësaj kontrate. Megjithatë, vlera e saktë e NEI-t, do të shprehet në planin e pagesave, i cili do të dorëzohet Qiramarrësit, ditën e dorëzimit të automjetit.
- 7.2 Norma Efektive e Interesit NEI, është totali i kostos së financimit për klientin Qiramarrës e shprehur si përqindje vjetore e vlerës së financimit të dhënë. Kostoja totale e kredisë për klientin është totali i të gjitha shpenzimeve ku përfshihen interesat, komisionet dhe çdo lloj tjetër shpenzimi, që klienti paguan për kredinë sipas kushteve të marrëveshjes së Qirasë Financiare.
- 7.3 Në varësi të ndryshimit të Normës Bazë të Interesit (apo edhe të kuotës fikse e të pandryshueshme të interesit vjetor) apo elementeve të tjerë bazë në llogaritjen e tij, do të

ndryshojë edhe Norma Efektive e Interesit. Metoda e llogaritjes së normës efektive të interesit për Qirane është si në vijim. Ekuacioni bazë për llogaritjen e normës efektive të interesit (NEI), barazon në një bazë vjetore, nga njëra anë vlerën totale aktuale të qirasë, duke zbritur cdo shpenzim të mbajtur (për shembull, shpenzimet administrative etj.) të vënë në dispozicion të klientit sipas marreveshjes së qirasë financiare dhe në anën tjetër vlerën totale aktuale të shlyerjeve dhe/ose të pagesave të shpenzimeve:

$$\sum_{k=1}^m K_k (1+i)^{-tk} = \sum_{l=1}^{m'} R_l (1+i)^{-tl}$$

Ku:

m – është numri total i kësteve të qirasë, nëse levrimi i qirasë bëhet me këste të paguar nga Qiradhënësi

k – është kësti i k-të i qirasë (nëse levrimi i qirasë bëhet me këste) të paguara nga qiradhënësi, kështu që $1 < k < m$.

K_k – është vlera e këstit të qirasë së vënë në dispozicion të klientit në periudhën k.

tk – është intervali, I shprehur në vite dhe fraksione të një viti, ndërmjet datës së vlerës së këstit të parë të qirasë të vënë në dispozicion të klientit (nëse levrimi I qirasë bëhet me këste) dhe datës së cdo kësti pasues të qirasë të vënë në dispozicion të klientit, domethënë $t_1=0$.

m' – është numri total I kësteve të paguara nga klienti për shlyerjen e qirasë dhe/ose pagesave të shpenzimeve.

l – është e l-të e paguara nga klienti për shlyerjen e qirasë (shlyerja ose pagesa e shpenzimeve).

R_l – është vlera e këstit të shlyerjes ose pagesës së shpenzimeve nga klienti në periudhën l.

tl – intervali, i shprehur në vite dhe fraksione të një viti, ndërmjet datës së levrimit të këstit të parë të qirasë të vënë në dispozicion të klientit (nëse levrimi i qirasë bëhet me këste) ose datës së levrimit të qirasë, në rast se levrimi i qirasë bëhet i plotë dhe datës së cdo kësti për shlyerje dhe/ose pagimi shpenzimesh vijuese që paguan klienti.

i=NEI është norma efektive e interesit, e cila mund të llogaritet (nga algjebra ose nga një program kompjuteri) kur termat e tjerë në ekuacion janë të njohur nga kontrata ose ndryshe.

“Shembull mbi llogaritjen e NEI : Shuma e qirasë është 1000 euro, por qiramarrësit i mbahen 50 euro për shpenzime administrative, kështu që qiraja është në fakt 950 euro. Shlyerja e të gjithë shumës prej 1200 eurove bëhet 1.5 vjet pas marrjes së qirasë.

Ekuacioni shndërrohet:

$$950 = 1200 / (1+i)^{547.5/365} = 1200 / (1+i)^{547.875/365.25} = 1200 / (1+i)^{18/12} = 1200 / (1+i)^{78/52}$$

$$\text{Ose: } (1+i)^{1.5} = 1200/950 = 1.263157$$

$$1+i = 1.168526$$

$$i = 0.168526$$

Kjo shifer do te rrumbullakoset në 16.9%”

7.4 Qiramarrësi deklaron se, është vënë në dijeni nga ana e Qiradhënësit, dhe se kupton që interesi i aplikuar mbi këstet e qirasë është i ndryshueshëm dhe merr përsipër rrezikun e humbjeve që mund të shkaktohen për të, si rrjedhojë e rritjes së normës së interesit vjetor kontraktor, pasojë e rritjes së Normës Bazë të Interesit përgjatë kohëzgjatjes së kësaj kontrate. Qiramarrësi deklaron se, është vënë në dijeni nga ana e Qiradhënësit, dhe se kupton dhe merr përsipër rrezikun e humbjeve që mund të shkaktohen për të, si rrjedhojë e ndryshimeve të kursit të këmbimit të monedhës (në të cilën shprehet qiraja financiare), me monedhën vendase dhe anasjelltas.

7.5 Qiramarrësi deklaron se ka dijeni dhe ka kuptuar plotësisht koston totale të qirasë financiare, si dhe mënyrën dhe formulën matematike të llogaritjes së NEI sa më lart. Ndryshimi i normës efektive të interesit, do t'i njoftohet Qiramarrësit sipas mënyrave të parashikuara në Nenin 11 të kësaj kontrate. Qiramarrësi deklaron se, është vënë në dijeni nga ana e Qiradhënësit, dhe se kupton që interesi i aplikuar mbi këstet e qirasë është i ndryshueshëm dhe merr përsipër rrezikun e humbjeve që mund të shkaktohen për të, si rrjedhojë e rritjes së normës së interesit vjetor kontraktor, pasojë e rritjes së Normës Bazë të Interesit, përgjatë kohëzgjatjes së kësaj

kontrate.

- 7.6 Këto deklarime, Qiramarrësi i bën në përputhje me informacionin e vënë në dispozicion nga Qiradhënësi, kjo dhe në zbatim të kërkesave të Rregullores “Mbi transparencën për produktet dhe shërbimet bankare e financiare” miratuar me Vendimin nr. 59, datë 29.08.2008 të Këshillit Mbikqyrës të Bankës së Shqipërisë, i ndryshuar.
- 7.7 Qiramarrësi deklaron se ka marrë vendimin për lidhjen e kësaj kontrate, pasi ka shqyrtuar, kuptuar dhe pranuar, kushtet e kësaj kontrate, që i janë paraqitur Qiramarrësit nga ana e Qiradhënësit, në formën e informacionit standard parakontraktor në përputhje me kuadrin rregullator të Bankës së Shqipërisë.

8. DORËZANËSIT

- 8.1 Qiramarrësi në përputhje me informacionin e vënë në dispozicion nga Qiradhënësi janë bashkërisht dhe veçmas përgjegjës kundrejt Qiradhënësit për të gjitha detyrimet e Qiramarrësit sipas Kontratës së Qirasë Financiare dhe, në rast se detyrimi sipas Kontratës së Qirasë Financiare është bërë i pagueshëm, Qiradhënësi është i autorizuar të kërkojë përmbushjen e detyrimit ose implementimin e ekzekutimit të të gjitha aseteve, nga Qiramarrësi dhe nga dorezanësi.
- 8.2 Në rast të vonesave në përmbushjen e detyrimeve kontraktore, dorezanësi merr përsipër kryerjen e të gjitha pagesave kundrejt Qiradhënësit apo kundrejt personit të përcaktuar nga Qiradhënësi. Dorezanësi bie dakord, se të gjitha njoftimet e zbatueshme ndaj Qiramarrësit dhe dorezanësit do t'i paraqiten ekskluzivisht Qiramarrësit.

9. VONESAT / PASOJA LIGJORE

- 9.1 Palët bien dakord se përmbushja e detyrimeve brenda afateve të përcaktuara në Kontratën e Qirasë Financiare, si dhe veprimi i palëve në përputhje me parimet e ndërgjegjes dhe ndershmërisë, përbëjnë një element të rëndësishëm të Kontratës së Qirasë Financiare. Qiramarrësi është i detyruar të informojë menjëherë me shkrim Qiradhënësin lidhur me vonesat në kryerjen e pagesave, me kusht që një gjë e tillë, nuk do të vonojë maturimin e detyrimit për kryerjen e pagesës nga Qiramarrësi.
- 9.2 Në rast mospërmbushje, për çfarëdo arsye të Qiramarrësit në pagesën e çdo shume të Qirasë Financiare sipas kësaj Kontrate, Qiradhënësi përveç normës së interesit nominal të përcaktuar, ka të drejtë të aplikojë një kamatë vonesë në masën prej IR (Interes rate) + 2% në vit, duke filluar nga dita e parë e afatit të kamatvonesës dhe deri në datën në të cilën kjo shumë e papaguar, paguhet e gjitha.
- 9.3 Në rast se Qiramarrësi vonon pagesën e ndonjë detyrimi sipas Kontratës së Qirasë Financiare për më shumë se 15 ditë, Qiradhënësi do të nisë procedurën e paralajmërimit dhe do të paraqesë Qiramarrësit një paralajmërim çdo 15 ditë për kohëzgjatjen e vonesës. Në bazë të tarifës për llogaritjen dhe përpunimin e të ardhurave të arkëtueshme, Qiradhënësi do të ngarkojë Qiramarrësit për këto vonesa shumë në vijim: shumë në vlerën 10 EURO (dhjetë euro) për paralajmërimin e parë, 15 EURO (pesëmbëdhjetë Euro) për paralajmërimin e dytë, 20 EURO (njëzet euro) për paralajmërimin e tretë. Mënyra e llogaritjes për çdo paralajmërim, sipas ditëvonesave, kryhet si më poshtë

Shëmbull : Kësti mujor : 200 Eur ;

Data e lëshimit të këstit , sipas faturës tatimore të shitjes referuar planit të pagesave: 03.06.2021

Data e maturimit të këstit : 15.06.2021

Në rast se pas 17 ditës ose ditën e dytë të punës së muajit pasardhës nga data e lëshimit të këstit (02.07.2021)

në rast se klienti nuk ka kryer asnjë pagesë, skema e përlllogaritjes do të jetë :

*Përlllogaritje e interesit të vonesës $I = 200 \text{ Eur} * 2 \% * 17 \text{ ditë} / 360 \text{ ditë} = 0,19 \text{ Eur}$*

Qiramarrësit i aplikohet penaliteti i parë : $10 \text{ Eur} + 0,19 \text{ Eur} = 10,19 \text{ Eur}$

- 9.4 Nëse Qiramarrësi, nuk përmbush detyrimet që rrjedhin nga Kontrata e Qirasë Financiare pas

paralajmërimit të tretë të dërguar më postë të regjistruar, do të konsiderohet në mënyrë të pakthyeshme se rrethanat e dhëna përcaktojnë se Qiramarrësi nuk do të përmbushë ndonjë prej detyrimeve të mëtejshme që lindin nga Kontrata e Qirasë Financiare dhe as ato që do të vijnë më pas detyrimeve që Qiramarrësi nuk ka përmbushur dhe palët bien dakord se Qiradhënësi në një rast të tillë do të jetë i autorizuar të:

- a) aktivizojë instrumentet e garancisë së pagesave për të gjithë shumën e të gjitha kësteve të Qirasë Financiare të pashlyera pavarësisht maturimit të tyre, nëse është rënë dakord se pas pagesës së të gjithë shumës (kryegjësë, interesave, kostove), Qiramarrësi do të bëhet pronari i ligjshëm i Objektivit të Qirasë Financiare; ose
- b) njoftojë qiramarrësin se Kontrata e Qirasë Financiare do të zgjidhet dhe do të kërkojë kryerjen e pagesave të të gjitha kësteve dhe kostove të pagueshme si dhe kthimin e objektivit të qirasë financiare që do të thotë sekuestrimin e Objektivit të Qirasë Financiare.

9.5 Qiramarrësi do të kompensojë Qiradhënësin lidhur me të gjitha kostot e tjera që lidhen me mbledhjen e të ardhurave të arkëtueshme sipas Kontratës së Qirasë Financiare (shpenzimet gjyqësore, administrative, shpenzimet e avokatit, vlerësimet e ekspertëve, kostot për kthimin e Objektivit të Qirasë Financiare, etj) maturimi i të cilave do të përcaktohet përmes faturave të paraqitura nga Qiradhënësi tek Qiramarrësi lidhur me këto kosto.

9.6 Palët bien dakord se të gjitha afatet e përcaktuara në këto AKP do të konsiderohen si afatet e duhura për përmbushjen e detyrimeve të Qiramarrësit. Në përputhje me parashikimet e ligjit për Qiranë Financiare, Palët bien dakord se në rast të vonesave në kryerjen e pagesave të Kësteve të Qirasë Financiare në përputhje me Kontratën e Qirasë Financiare, Qiradhënësi do të ketë të drejtë të ri-marrë mbrapsht Objektivin e Qirasë Financiare, për ta ri-vënë atë nën posedimin e tij.

9.7 Në rast se Qiramarrësi ka përdorur mjetet për sigurimin e pagesave, sipas Kontratës së Qirasë Financiare dhe Palët pas kësaj bien dakord se Kontrata, do të vazhdojë të qëndrojë në fuqi, Qiramarrësi është i detyruar ti paraqesë Qiradhënësit mjete të reja të përshtatshme dhe të rregullta për sigurimin e pagesës të cilat do të zëvendësojnë mjetet e përdorura për sigurimin e pagesave të jo më vonë se 3 (tre) ditë nga dita e arritjes së marrëveshjes. Nëse Qiramarrësi nuk vepron si është përcaktuar dhe brenda afatit të parashikuar, do të konsiderohet se Kontrata e Qirasë Financiare nuk është më në fuqi.

10. MIRËMBAJTJA / PËRGJEGJËSIA PËR OBJEKTIN E QIRASË FINANCIARE

10.1 Qiramarrësi përmes kësaj Kontrate merr përsipër me shpenzimet dhe kostot e veta, të mirëmbajtjes sic duhet Objektivin e Qirasë Financiare (mirëmbajtja e zakonshme dhe e jashtëzakonshme) për si një sipërmarrës/pronar i mirë, të kujdeset në vazhdimësi të gjitha riparimet dhe shërbimet e nevojshme si dhe të kryejë një mirëmbajtje në mënyrë të vazhdueshme me qëllim ruajtjen e kushteve perfekte, funksionale dhe mjedisore të sigurta të Objektivit të Qirasë Financiare në përputhje me afatet dhe kushtet e përgjithshme të prodhuesit të pajisjeve, me AKP, Kontratën e Qirasë Financiare. Qiramarrësi është përgjegjës për dëmet që mund të lindin nga shkelja e detyrimeve që rrjedhin nga dokumentet e lartpërmendura.

10.2 Mirëmbajtja dhe riparimi i Objektivit të Qirasë Financiare mund të kryhet ekskluzivisht në dyqanet servisit të Dorëzuesit ose në serviset e autorizuar të cilët janë miratuar dhe konfirmuar në listën e garancisë ose në librin e shërbimit. Gjatë mirëmbajtjes së Objektivit të Qirasë Financiare, qiramarrësi merr përsipër të përdorë ekskluzivisht vetëm pjesë këmbimi origjinale. Mbi bazën e kërkesës së Qiradhënësit, nëse një gjë e tillë është objektivist e mundur dhe e arsyeshme, qiramarrësi do të lidhë një marrëveshje për shërbime/mirëmbajtje për Objektivin e Qirasë Financiare.

10.3 Qiramarrësi është i detyruar ta përdorë Objektivin e Qirasë Financiare në përputhje me rregulloret e zbatueshme ligjore, në të kundërt Qiramarrësi është përgjegjës për pasojat që rrjedhin prej tyre si dhe do të paguajë të gjitha penalitetet e parashikuara lidhur me to pranë organeve

kompetente. Nëse për shkak të dështimit nga ana e Qiramarrësit, Qiradhënësi paguan një gjobë në një shumë të caktuar të cilës i shtohen kosto të tjera të procedurave të cilat përfshijnë tarifat për përfaqësimin dhe/ose mbrojtjen, shpenzime dhe kosto të tjera, Qiradhënësi është i autorizuar t'i ngarkojë Qiramarrësit kamatë-vonesat duke filluar nga dita në të cilën pagesat janë kryer ose në ditën e paraqitjes së vendimit mbi gjobën, plus 100 EUR (njëqind euro), shumë e cila do të paguhet nga Qiramarrësi në përputhje me vlerën në ditën e njoftimit mbi shumën e pagesës (me faturë).

- 10.4 Nëse Qiramarrësi instalon vetë çelësa shtesë, pajisje alarmi dhe pajisje të tjera të ngjashme për mbrojtjen e Objektit të Qirasë Financiare, ai do të informojë Qiradhënësin dhe do të pajisë Qiradhënësin me të gjitha mjetet e nevojshme për zhbllokimin e Objektit të Qirasë Financiare.
- 10.5 Qiramarrësi merr përsipër se gjatë gjithë kohëzgjatjes së Kontratës së Qirasë Financiare të gjitha pajisjet e nevojshme të përcaktuara nga legjislacioni dhe rregulloret e zbatueshme në fuqi duhet të jenë të pranishme në Objektin e Qirasë Financiare dhe se këto pajisje duhet të jenë funksionale dhe të provuara/vërtetuara (si për shëmbull trekëndëshi, ndihma e shpejtë, seti i dritave, aparati kundër zjarrit etj.,) ose pajisje të tjera në funksion të Objektit të Qirasë Financiare të përcaktuara nga legjislacioni dhe rregulloret e zbatueshme në fuqi. Nëse, për shkak të mungesës ose mangësive të pajisjeve, Qiradhënësi ose personi i autorizuar nga Qiradhënësi gjohet, Qiramarrësi është i detyruar të kompensojë të gjithë shumën e një gjobe të tillë.
- 10.6 Qiramarrësi duhet të mbajë në çdo kohë, të gjithë dokumentacionin lidhur me përdorimin e Objektit të Qirasë Financiare. Në rast të shkakut të dëmeve (si p.sh. vjedhje) dhe në të njëjtën kohë të pamundësisë për të ushtruar të drejtën që rrjedh nga sigurimi për shkak të mos-pasjes së dokumentacionit, Qiramarrësi është ekskluzivisht përgjegjës për dëmin e shkaktuar.
- 10.7 Në rast të humbjes së çelësit të automjetit, të dokumentit të regjistrimit, kodi të kartës ose çelësit master, Qiramarrësi është i detyruar të informojë Qiradhënësin dhe shoqërinë e sigurimit me shkrim lidhur me këtë brenda 7 (shtatë) ditësh.

11. NJOFTIMET MES PALËVE DHE EKZAMINIMI I AUTOMJETIT

- 11.1 Çdo njoftim, kërkesë ose komunikim midis palëve do të bëhet me shkrim dhe do të dërgohet me letër rekomande ose poste të regjistruar në adresat e tyre të përcaktuara në këtë kontratë ose në adresat e njoftuara më pas nga secila prej palëve dhe do të konsiderohet e marrë (dorëzuar) në momentin e nënshkrimit të dokumentit përkatës të marrjes në dorëzim nga pala pritëse dhe në rast se ky nuk gjendet, njoftimi i dorëzohet njërit prej anëtarëve të familjes, fqinjëve ose portierit të ndërtesës. Kur është e mundur, njoftimi mund të kryhet edhe me një mjet të qëndrueshëm komunikimi (përfshirë e-mail) ose mesazhe telefonike. Në rast të ndryshimit të adresave të kontaktit, Qiramarrësi ka detyrimin të njoftojë Qiradhënësin 15 ditë përpara për çdo ndryshim të adresës së tij postare, e-mail apo edhe të kontaktit të tij telefonik, në të kundërt njoftimi do të konsiderohet i realizuar në adresat e fundit të komunikuar.
- 11.2 Qiramarrësi do të njoftojë menjëherë Qiradhënësin pa vonesa, me çdo ndryshim të selisë së tij ligjore, ose të adresës së tij të banimit, të punëdhënësit të tij, konfiskimin ose dëmtimin e Objektit të Qirasë Financiare. Nëse Qiramarrësi nuk përmbush detyrimet e tij sipas paragrafit këtu më sipër të këtij neni, çdo njoftim i paraqitur tek Qiramarrësi lidhur me adresën e përcaktuar në Kontratën e Qirasë Financiare, do të konsiderohet si e njoftuar rregullisht vlefshëm, pavarësisht nëse Qiramarrësi ka marrë ose jo në dorëzim njoftimin dhe dita e dorëzimit të tij në postë do të konsiderohet si dita e pranimit.
- 11.3 Qiradhënësi ose çdo person i përcaktuar nga Qiradhënësi është i autorizuar të shqyrtojë Objektin e Qirasë Financiare në çdo kohë të arsyeshme dhe Qiramarrësi është i detyruar të lejojë aksesin e drejtpërdrejtë në të. Qiramarrësi nuk mund ngrejë pretendime kundrejt Qiradhënësit për shqyrtimin e Objektit të Qirasë Financiare dhe ai nuk zotëron të drejtën e vetë-ndihmës. Nëse Qiramarrësi nuk i lejon Qiradhënësit ekzaminimin e Objektit të Qirasë Financiare, Qiradhënësi

ka të drejtë të zgjidhe Kontratën e Qirasë Financiare në mënyrë të njëanshme.

12. DËMI SI PASOJE E AKSIDENTIT/VJEDHJES

- 12.1 Në rast të një aksidenti, Qiramarrësi do të dorezoje Objektin e Qirasë Financiare ekskluzivisht në dyqanin e servisit më të afert dhe do ti paraqesë Qiradhënësit një raport me shkrim për dëmin e shkaktuar. Qiramarrësi merr përsipër së do të marre të gjitha veprimet dhe masat e nevojshme në përputhje me afatët dhe kushtët e përcaktuara për procedurën e raportimit, vlerësimit dhe likuidimit të dëmeve.
- 12.2 Në rast të vjedhjes së Objektit të Qirasë Financiare, Qiramarrësi është i detyruar të raportojë vjedhjen në stacionin më të afert të policisë dhe të informojë Qiradhënësin menjëherë. Në atë rast, Kontrata do të zgjidhet brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga data e raportimit për vjedhjen, përveç nëse Objektit të Qirasë Financiare gjendet gjatë kësaj periudhe dhe kthehet tek Qiradhënësi. Në një rast të tillë, Qiradhënësi ushtron të drejtën të llogarisë shumën e kështit të Qirasë Financiare për përdorimin e Objektit të Qirasë Financiare deri në ditën e fundit të muajit kalendarik në të cilin ai ka marrë konfirmimin për vjedhje të Objektit të Qirasë Financiare nga rajoni kompetent i policisë.
- 12.3 Në rast se dëmi i shkaktuar, për çdo lloj arsye, nuk kompensohet Shoqëria e sigurimit ose nëse shoqëria e sigurimit nuk është e detyruar të paguajë dëmet, bazuar në kushtët dhe afatet e sigurimit, Qiramarrësi është i detyruar t'i paguajë Qiradhënësit të gjithë dëmin si dhe t'i kompensojë atij të gjitha kostot shtesë, që do të thotë të kthejë Objektit të Qirasë Financiare në gjendjen e mëparshme me shpenzimet e veta. Shuma e dëmit do të vlerësohet nga një ekspert i kualifikuar i përcaktuar nga Qiradhënësi. Qiramarrësi është i detyruar t'i paguajë Qiradhënësit shumën e vlerësuar të dëmit dhe të gjitha kostot e shumës së vlerësuar të dëmit brenda 8 (tetë) ditëve nga vlerësimi i dëmit. Qiramarrësi pranon/lejon se mjetet/instrumentët për sigurimin e pagesave sipas Kontratës së Qirasë Financiare, mund të përdoren për qëllime të kompensimit të dëmeve të shkaktuara.
- 12.4 Vetëm Qiradhënësi është i autorizuar të leshojë deklarata të shlyerjes së borxheve/detyrimeve. Nënshkrimi i deklaratës së shlyerjes së borxhit/detyrimit nuk do të nënkuptojë se të gjitha të ardhurat e arkëtueshme, që do të përfiton Qiradhënësi nga Qiramarrësi sipas Kontratës së Qirasë Financiare, janë shlyer plotësisht.
- 12.5 Të gjitha shumat e mundshme për kompensimin e dëmeve materiale të shkaktuara, do t'i paguhën Qiradhënësit.
- 12.6 Qiradhënësi nuk do të japë miratimin e tij për riparim, apo urdhër për riparim të dëmeve në Objektin e Qirasë Financiare, deri në momentin kur Qiramarrësi të ketë paguar të gjitha detyrimet e pashlyera kundrejt Qiradhënësit sipas Kontratës së Qirasë Financiare.

13. PËRFUNDIMI I KONTRATËS

- 13.1 Qiradhënësi do të informojë Qiramarrësin përmes postës së regjistruar me konfirmim marrje, lidhur me përfundimin e Kontratës së Qirasë Financiare (njoftimi për zgjidhje):
- nëse Qiramarrësi refuzon të marre në dorezim Objektin e Qirasë Financiare në afatin e përcaktuar;
 - nëse Qiramarrësi jep të dhëna të pasakta lidhur me përdorimin ose kushtët e Objektit të Qirasë Financiare;
 - nëse Qiramarrësi ose dorezanësi japin të dhëna të rreme, lidhur me situatën e tyre financiare si p.sh. të fitimet, të ardhurat, pasuria dhe/ose nëse është përcaktuar së gjendja pasurore e Qiramarrësit është shumë e ndryshme nga ajo e përcaktuar bazuar në informacionin e marrë, e tillë që Qiradhënësi nuk do të nënshkruante një kontratë qiraje me të tilla;
 - nëse ndonjë prej mjeteve/instrumenteve për sigurimin e pagesës dhe/ose urdhër pagese i parashikuar Kontratën e Qirasë Financiare bëhet e pavlefshme/jo e mundshme për tu përdorur nga Qiradhënësi sipas Kontratës së Qirasë Financiare për çdo lloj arsye;

- nëse fillon një procedure falimentimi dhe likuidimi kundrejt Qiramarrësit ose nëse Qiramarrësi për çfaredo lloj arsye ndodhet në gjendjen e paaftësisë pague;e;
 - nëse Qiramarrësi është pjesërisht ose plotësisht në vonesë përmbushjen dhe kryerjen e pagesave të Kësteve të Qirasë Financiare ose pagesave të tjera të detyrueshme sipas Kontratës së Qirasë Financiare dhe pavarësisht paralajmerimeve Qiramarrësi vazhdon të mos përmbushë detyrimin e tij brenda afatit të parashikuar në përputhje me AKP;
 - nëse Qiramarrësi nuk përmbush dispozitat e nënit 4 të kësaj Kontrate;
 - në rast të debitimit të plotë, shkatërrimit, vjedhjes ose humbjes së Objektit të Qirasë Financiare;
 - nëse Qiramarrësi zëvendëson selinë/qëndrimin e tij, ose rezidencën në një shtet të huaj, në rast të vdekjes së tij, nëse ai behet i paaftë për të punuar ose vepruar ose nëse nuk ekziston asnjë pasardhës i tij i ligjshëm apo trashëgimtar i tij;
 - në rast se Qiramarrësi nuk e përdor dhe/ose mirëmban Objektin e Qirasë Financiare, në përputhje me Kontratën e Qirasë Financiare;
 - në rast të rrezikut ose rrethanave të jashtëzakonshme, të cilat sipas vlerësimit të Qiradhënësit, rrezikojnë ose vonojnë përmbushjen e detyrimeve kontraktore të Qiramarrësit ose nëse Qiradhënësi vlerëson së Qiramarrësi, nuk do të jetë i aftë të përmbushë detyrimet e tij kontraktore;
 - nëse Qiramarrësi i nënshtrohet ndonjë procedurë bashkimi ose një ndryshimi tjetër të formes ligjore/statusit të tij në përputhje me ligjin 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, pa informuar paraprakisht Qiradhënësin lidhur me këtë;
 - nëse Qiramarrësi shkel rëndë parashikimet e Kontratës së Qirasë Financiare;
 - për shkaqe të tjera të përcaktuara shprehimisht nga Ligji për Qiranë Financiare.
- 13.2 Kontrata e Qirasë Financiare do të konsiderohet e zgjidhur në ditën në të cilën Objekti i Qirasë Financiare i kthehet Qiradhënësit, pavarësisht momentit në të cilin Qiramarrësi ka marrë në dorëzim njoftimin për zgjidhje. Deri në ditën e kthimit të Objektit të Qirasë Financiare, Qiramarrësi duhet të shlyejë të gjitha detyrimet e tij, që rrjedhin nga Kontrata e Qirasë Financiare, pavarësisht datës, në të cilën është marrë njoftimi për zgjidhjen.
- 13.3 Në rast të përfundimit ose të pezullimit të përkohshëm të Kontratës së Qirasë Financiare, Qiradhënësi do të ketë të drejtë t’i ngarkojë Qiramarrësit, të gjithë shume e pashlyer subjekt i financimit së bashku me të gjitha dëmet, përfshirë ketu fitimin e munguar të cilin Qiradhënësi do të kishte përfituar nëse Kontrata e Qirasë Financiare nuk do të ishte pezulluar përkohësisht. Në përputhje me sa me sipër, Qiradhënësi është i autorizuar të llogaritë dhe t’i ngarkojë Qiramarrësit të gjitha shumat e papaguara të kësteve të qirasë financiare në një shumë të vetme, në përputhje me Planin e Pagesave dhe të gjitha të shpenzimet (administrative, gjyqësore, shpenzimet e avokatit, kostot e servisit, mirëmbajtjes, ruajtjes dhe kthimit të Objektit të Qirasë Financiare, transportit etj.).
- 13.4 Pas dërgimit të njoftimit për zgjidhjen e Kontratës së Qirasë Financiare, Qiradhënësi është i autorizuar të marrë në zotërim Objektin e Qirasë Financiare pa asnjë njoftim paraprak drejtuar Qiramarrësit. Qiramarrësi deklaron së heq dorë nga e drejta e mbrojtjes nga nderhyrja e panjoftuar e Qiradhënësit, në rast se Qiradhënësi apo personi i autorizuar prej tij duhet të marrë në zotërim Objektin e Qirasë Financiare si dhe të drejtën për vetë-ndihmë.
- 13.5 Në rast të marrjes në zotërim të Objektit të Qirasë Financiare dhe në rast të zgjidhjes së Kontratës së Qirasë Financiare, Qiramarrësi është i detyruar të lejojë/mundësojë Qiradhënësin ose personin e autorizuar prej tij të ketë akses të drejtpërdrejtë në Objektin e Qirasë Financiare dhe Qiramarrësi është gjithashtu i detyruar të mos pengojë procedurën për kthimin e Objektit të Qirasë Financiare tek Qiradhënësi dhe në këtë mënyrë ai heq dorë nga çdo kërkesë/pretehim i mundshëm për dëme sipas sa me sipër ose sipas cdo baze tjetër.
- 13.6 Qiradhënësi bazuar në Nenin 8 të Ligjit Nr. 72/2019 "Për Masat Kufizuese Ndërkombëtare", është e detyruar ta ndërpresë Kontratën e Qirasë Financiare me efekt të menjëhershëm për Qiramarrësin ose të gjitha palët kontraktuese nëse, në veçanti, zbatohet një nga arsyet e

mëposhtme:

a) Qiramarrësi nuk i ofron Qiradhënësit informacionin dhe dokumentet e kërkuara për të përmbushur detyrimet e tij sipas Nenit 4, 4/1 dhe 5 mbi "Për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit" (p.sh., informacion dhe prova në lidhje me pronarët përfitues/përfituesit dhe përfaqësuesit e autorizuar, qëllimin e marrëdhënies së biznesit, origjinën e fondeve, ekzistencën e një marrëdhënie besimi) dhe nuk e informon menjëherë Qiradhënësit për çdo ndryshim në këtë drejtim.

b) Qiramarrësi është i listuar në listat e sanksioneve të BE-së ose SHBA-së ose në listat e sanksioneve të publikuara në autoritetet lokale si Banka e Shqipërisë dhe Agjencia e Inteligjencës Financiare.

14. PASOJAT LIGJORE TË PËRFUNDIMIT TË KONTRATËS

14.1 Në rast të zgjidhjes së Kontratës së Qirasë Financiare, Qiramarrësi është i detyruar të kompensojë Qiradhënësin lidhur me të gjithë dëmin e shkaktuar si rezultat i përfundimit të Kontratës së Qirasë Financiare.

14.2 Qiramarrësi merr përsipër veçanërisht, ndër të tjera, t'i paguajë Qiradhënësit si kompensim për dëmet sa më poshtë:

a) diferencën e mundshme të përcaktuar midis vlerës së Objektit të Qirasë Financiare të përcaktuar në librat dhe dokumentet e Qiradhënësit (planit të pagesave) dhe vlerës së automjetit nga kontrata e re e qirasë e lidhur me Qiramarrësin tjetër, për të njëjtin Objekt të Qirasë Financiare.

b) dëmi (fitimi i munguar) i shkaktuar në periudhën midis kthimit të Objektit të Qirasë Financiare të Qiradhënësi dhe lidhja e një kontrate të re sipas të cilës Qiramarrësi i ri merr në dorëzim Objektin e Qirasë Financiare; këto dëme do të përcaktohen në shumën mujore të Kestit të kontraktuar të Qirasë Financiare për çdo muaj të kësaj periudhe.

14.3 Shuma e papaguar e Kësteve të Qirasë Financiare dhe kompensimi për dëme bëhet i pagueshëm menjëherë pas dorëzimit nga Qiradhënësi të Qiramarrësi të llogaritjes përfundimtare dhe Qiradhënësi do të ketë të drejtë përdorë të gjitha mjetet/instrumentet e disponueshme, për sigurimin e pagesës përfshirë këtu edhe dorezanësit.

14.4 Fondet e paguara paraprakisht përbejnë një pjesë të llogaritjes së Kësteve të kontraktuara të qirasë Financiare dhe në asnjë rast nuk do ti kthehen Qiramarrësit.

15. KTHIMI I OBJEKTIT TË QIRASË FINANCIARE/ VENDI DHE KOHA

15.1 Në rast të përfundimit të Kontratës së Qirasë Financiare përpara afatit të caktuar, Qiramarrësi është i detyruar të kthejë Objektin e Qirasë Financiare të Qiradhënësi, në kushte perfekte dhe të sigurt për trafik, të cilat janë të pritshme si rezultat i rrethanave normale dhe të zakonshme të përdorimit, si dhe të pajisur me të gjitha pajisjet dhe mjetet standarde, dokumentacionin teknik dhe të gjitha çelësat. Në rast të kundërt, Qiramarrësi është i detyruar të dëmshpërblejë Qiradhënësin në lidhje me të gjitha dëmet e vlerësuara nga eksperti i autorizuar (vlerësuesi i autorizuar ose vlerësues i shoqërisë së sigurimit i përcaktuar nga Qiradhënësi). Kostot lidhur me vlerësimin e mundshëm të Objektit të Qirasë Financiare do ti ngarkohen Qiramarrësit dhe do të përcaktohen nga përllogaritja përfundimtare e cila do ti dërgohet Qiramarrësit.

15.2 Nëse Qiramarrësi bën ndryshime të caktuara në Objektin e Qirasë Financiare (pajisje shtesë, përmirësime etj.) përmirësimet e kryera do të kalojnë në pronësi të Qiradhënësit. Qiramarrësi nuk do të ketë të drejtë të kërkojë rimbursimin për këto kosto. Në një rast të tillë, Qiramarrësi duhet të kthejë Objektin e Qirasë Financiare në të njëjtat kushte në të cilat Objekti i Qirasë Financiare ka qenë në kohën e lidhjes së Kontratës së Qirasë Financiare (duke hequr pjesët dhe/ose pajisjet) nëse heqja e këtyre pjesëve dhe/ose pajisjeve nuk do të pakësojë vlerën e funksionimit të Objektit të Qirasë Financiare.

15.3 Vendi dhe koha e kthimit të Objektit të Qirasë Financiare do të përcaktohet nga Qiradhënësi.

Në momentin e kthimit, Palët do të hartojnë një procesverbal për kthimin e Objektivit të Qirasë Financiare në të cilin do të përcaktohet numri i kilometrave të kryera në momentin e kthimit të Objektivit të Qirasë Financiare si dhe i cili do të përcaktojë të gjitha defektët/defektët e fshehura si dhe kostot e riparimit të tyre.

- 15.4 Nëse Qiramarrësi nuk kthen Objektivin e Qirasë Financiare në mënyrën e përcaktuar, do të konsiderohet se Qiramarrësi ka disponuar Objektivin e Qirasë Financiare dhe një gjë e tillë do të autorizojë Qiradhënësin të organizojë vetë me shpenzimet dhe risqet e Qiramarrësit, kthimin e Objektivit të Qirasë Financiare dhe lëshimin e dokumenteve të reja dhe të çelësave. Në një rast të tillë, do të konsiderohet se Qiramarrësi, është i vetëdijshëm për pasojat e mundshme ligjore dhe penale që mund të vijnë si rezultat i sjelljes së tij, dhe se ai është i vetëdijshëm se kjo sjellje në kundërshtim me ligjin mund të çojë në lindjen e përgjegjësisë penale për Qiramarrësin ose personin e autorizuar prej tij, nëse Qiramarrësi është person juridik për shkak të kryerjes së veprave/veprimeve kriminale ndaj pronës/pasurisë. Qiramarrësi është gjithashtu i vetëdijshëm se në keto raste Qiradhënësi mund të ngrejë akuza penale kundrejt çdo personi përgjegjës.

16. KOSTOT PËR KTHIMIN E OBJEKTIT TË QIRASË FINANCIARE

- 16.1 Të gjitha kostot që mund të lindin për shkak të kthimit të Objektivit të Qirasë Financiare do të ngarkohen Qiramarrësit. Qiramarrësi gjithashtu heq dorë nga e drejta për të kërkuar kompensim për demin dhe kërkesat për ngarkimin e pagesave tashmë të shlyera të Këstëve të Qirasë Financiare dhe kosto të tjera. Në rast të sekuestrimit të Objektivit të Qirasë Financiare, Qiramarrësi është i detyruar të kompensojë Qiradhënësin lidhur me të gjitha kostot e lindura për shkak të rimarrjes së Objektivit të Qirasë Financiare. Qiramarrësi konfirmon se nuk do të kundërshtojë kërkesën e Qiradhënësit për pagesën e të gjitha kostove të udhëtimit të përfaqesuesit të Qiradhënësit ose të personave të zgjedhur prej tij si dhe as kërkesën për pagesën e të gjitha kostove për sekuestrimin ose kthimin e Objektivit të Qirasë Financiare.
- 16.2 Qiramarrësi pranon gjithashtu se nuk do të ngrejë pretendime për dëme kundrejt Qiradhënësit, në rast se Qiramarrësi çaktivizon alarmin dhe pajisje të tjera, të cilat bëjnë të pamundur zhvendosjen e Objektivit të Qirasë Financiare dhe të cilat janë instaluar pa miratimin paraprak me shkrim të Qiradhënësit. Qiradhënësi nuk është përgjegjës për sendet personale të gjetura në Objektivin të Qirasë Financiare në momentin e kthimit (sekuestrimit të Objektivit të Qirasë Financiare).

17. LLOGARITJA PËRFUNDIMTARE/VLERËSIMI I AUTOMJETIT

- 17.1 Në përfundim të afatit të Kontratës së Qirasë Financiare ose në rast të përfundimit të saj përpara afatit të përcaktuar në të, Qiradhënësi do të llogaritë të gjitha pagesat e Këstëve të Qirasë Financiare të kryera deri në atë datë, si dhe të gjitha pagesat e tjera sipas Kontratës së Qirasë Financiare, në bazë të të cilave ai do të kryejë një llogaritje përfundimtare e cila do të paraqitet Qiramarrësit së bashku me kërkesën për pagesë të detyrimeve të mundshme ende të pashlyera sipas Kontratës së Qirasë Financiare. Shuma e përcaktuar përmes llogaritjes përfundimtare do të paguhet nga Qiramarrësi me paraqitjen nga Qiradhënësi të një fature të veçantë në përputhje me llogaritjen përfundimtare dhe brenda afatit të përcaktuar në faturë. Pas përfundimit të kësaj periudhe, Qiradhënësi është i autorizuar të ndërmarrë dhe përdorë të gjitha mjetet ekzistuese për sigurimin e pagesave të paraqitura nga Qiramarrësi sipas Kontratës së Qirasë Financiare.
- 17.2 Në rast të financimit me vlerën e mbetur, sipas cilës është kontraktuar blerja e Objektivit të Qirasë Financiare dhe është mbajtur e drejta opsionale, në përfundim të afatit të kontraktuar të qirasë financiare, do të kryhet llogaritja përfundimtare ku vlera e mbetur do të jetë e vlefshme vetëm në rast të përmbushjes së detyrimeve të Kontratës së Qirasë Financiare.
- 17.3 Në rast të financimit me vlerën e mbetur dhe nëse në përfundim të afatit të kontraktuar të qirasë financiare, Qiramarrësi nuk do të përmbushë detyrimet e tij lidhur me të drejtën opsionale, do të konsiderohet se Kontrata e Qirasë Financiare është zgjidhur në mënyrë të njëanshme. Në një

rast të tillë, Qiramarrësi, në ditën e fundit të afatit të qirasë financiare, do t'i kthejë Qiradhënësit Objektivin e Qirasë Financiare, në dyqanin e servisit të autorizuar të dorëzuesit, në përputhje me nenin 13 të AKP, për vlerësimin/kontrollin e kushteve të Objektivit të Qirasë Financiare.

- 17.4 Në rast të vlerësimit/kontrollit të kushteve të Objektivit të Qirasë Financiare dhe llogaritjes përfundimtare lidhur me të, vlera e mbetur do të konsiderohet si vlera e kontraktuar që do të thotë si vlera në ditën e vlerësimit (vlera e tregut në ditën e vlerësimit) përveç nëse përmbushen kushtet në vijim:
- a) Vlera e Objektivit të Qirasë Financiare në ditën e vlerësimit (vlera e tregut në ditën e vlerësimit) i korrespondon proporcionalisht vlerës së mbetur të miratuar (vlera e cila është regjistruar në librat dhe dokumentet e Qiradhënësit);
 - b) Nëse deri në ditën e vlerësimit nuk ka ndryshime në rregullore (dogana, taksa etj) të cilat mund të ndikojnë në vlerën e mbetur ose mund të ndikojnë në zvogelimin e vlerës së mbetur (për shembull nëse ka zvogelim të doganës për automjete të reja për shkak të të cilave një automjet i ri do të jetë më i lirë, atëherë vlera e tregut të të njëjtit lloj e automjetit të përdorur do të llogaritet automatikisht në një nivel më të ulët).
 - c) Kilometrazhi është brenda limiteve të kilometrave të miratuara; nëse kilometrazhi vjetor tejkalon 2000 km, Qiramarrësi do të paguajë 30% të vlerës e cila del si rezultat i pjesëtimit të qirasë financiare mujore me një pjesën e plotë përkatëse të kilometrazhit vjetor. Totali i kilometrazhit të miratuar përftohet nga pjesëtimi i kilometrazhit vjetor me 12 muaj të miratuar. Nëse Kontrata e Qirasë Financiare shtrihet përtej periudhës e cila ka qenë baza e llogaritjes, tarifa e cila ka qenë e vlefshme në fund të periudhës që ka qenë baza e llogaritjes do të përdoret si baza për llogaritjen.
 - d) Objekti i Qirasë Financiare është përdorur brenda kufijve të përdorimit të zakonshëm
 - e) Objekti i Qirasë Financiare është mirëmbajtur dhe i janë kryer shërbimet përkatëse në përputhje me manualin e prodhuesit dhe të servisit të autorizuar;
 - f) gomat e verës (përfshirë gomat rezervë) kanë një profil të paktën 3mm, në të kundërt Qiramarrësi është i detyruar të mbartë kostot për blerjen e gomave të reja;
 - g) nëse Objekti i Qirasë Financiare ka nevojë për servis ose është objekt i një inspektimi/kontrolli ligjor brenda 30 ditëve në vijim, që do të thotë për 3000 Km e ardhshme, Qiramarrësi do të mbartë kostot për këtë servis/inspektim/kontroll. Një përcaktim i tillë i gjendjes/vlerësimit është ligjërisht detyrues, për të dyja palët. Qiramarrësi, është i detyruar t'i kompensojë Qiradhënësit cdo diferencë në vlerë (diferenca midis vlerës së tregut të Objektivit të Qirasë Financiare në ditën e vlerësimit dhe vlera e mbetur e kontraktuar), e cila do të përcaktohet përmes këtij vlerësimi.

18. E DREJTA PËR TË BLERË OBJEKTIN E QIRASË FINANCIARE/ZGJATJA E KONTRATËS

- 18.1 Në rast se e drejta opsionale është kontraktuar (blerja/zgjatja e qirasë financiare) Qiramarrësi, në përfundim të afatit të kontraktuar të Qirasë Financiare,do të fitojë të drejtën të blejë Objektivin e Qirasë Financiare në vlerën e mbetur të kontraktuar ose të drejtën për të zgjatur Kontratën e Qirasë Financiare me detyrimin për të njoftuar Qiradhënësin mbi zgjedhjen e njërit prej dy opsioneve jo me vonë se 1 (një) muaj përpara përfundimit të afatit të Kontratës së Qirasë Financiare afatet dhe kushtet e veçanta për përdorimin e të drejtës opsionale (që do të thotë vlefshmeria e vlerës së mbetur të kontraktuar, do të përcaktohet në Kontratë.
- 18.2 Qiramarrësi mund të emërojë/caktojë një palë të tretë në cilesinë e blerësit të Objektivit të Qirasë Financiare.
- 18.3 Nëse Qiramarrësi nuk ushtron të drejtën e përcaktuar në paragrafet më sipër brenda 8 (tetë) ditësh nga data e marrjes së llogaritjes përfundimtare, Qiradhënësi do të ketë të drejtë të shesë Objektivin e Qirasë Financiare tek një palë e tretë sipas cmimit të përcaktuar në llogaritjen përfundimtare ose me një çmim më të ulët.

18.4 Të gjitha kostot e blerjes dhe shitjes së Objektit të Qirasë Financiare, përfshire ketu taksat dhe shpenzimet përkatëse, do të mbartën nga blerësi.

18.5 Në rast se Qiramarrësi do të kerkojë nëpërmjet një kerkese me shkrim, të shlyejë të gjithë detyrimin e qirasë financiare, përpara afatit të përcaktuar në Kontratën e Qirasë Financiare, Qiramarrësi së bashku me shlyerjen e të gjithë pjesës së kryegjesë së mbetur është i detyruar të paguaje në favor të Qiradhënësit një komision të barabartë me 2% mbi pjesën e mbetur kryegjë (principali sipas planit të pagesave) + interes i papaguar, i qirasë financiare të mjetit.

Shembull: Përlllogaritja e komisionit:

Vlera e mbetur e principalit : 10.900Eur; Interesi mbetur, i papaguar : 1300 Eur

*Përlllogaritje e komisionit : $(10.900+1300) * 2\% = 244\text{Eur}$*

19. KOMPENSIMI PËR KOSTOT

19.1 Të gjitha shpenzimet, taksat, pagesat dhe kostot e tjera lidhur me nënshkrimin e Kontratës së Qirasë Financiare të lindura gjatë afatit të kohëzgjatjes së Kontratës së Qirasë Financiare, pavarësisht kur ato janë llogaritur për Qiramarrësin, do të mbarten nga Qiramarrësi, përveç rasteve kur janë dakortësuar ndryshe, sipas Anëks 2 bashkëngjitur kësaj kontrate.

19.2 Qiramarrësi ka detyrimin t'i rimbursojë Qiradhënësit çdo shumë të pagueshme nga Qiramarrësi, por të parapaguar nga Qiradhënësi. Qiramarrësi është i detyruar të kompensojë Qiradhënësin për të gjitha shpenzimet e bëra për pagesën, sigurimin dhe mbledhjen e detyrimeve nga pretendimet që rrjedhin si pasojë e kësaj Kontratë, si dhe të gjitha shpenzimet gjyqësore dhe jashtëgjyqësore, për shpenzimet e avokatëve dhe konsulentëve ligjorë, noterëve publikë, ekspertëve, shpenzimet për rimarrjen jashtëgjyqësisht të Objektit të Qirasë, etj. Qiradhënësi gjithashtu ka të drejtën e rimbursimit të shpenzimeve, për njoftimet paraprake.

20. JURIDIKSIONI

20.1 Në rast të mosmarrëveshjeve midis palëve lidhur me interpretimin dhe/ose zbatimin e Kontratës së Qirasë Financiare e cila nuk mund të zgjidhet me negociata midis palëve, keto mosmarrëveshje do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

21. TRANSFERIMI I TË DREJTAVE

21.1 Qiradhënësi mund të transferojë të drejtat dhe detyrimet e tij sipas Kontratës së Qirasë Financiare tek palë të treta pa cenuar të drejtat e Qiramarrësit sipas Kontratës së Qirasë Financiare. Në një rast të tillë Qiramarrësi nuk mund të zgjidhë Kontratën e Qirasë Financiare, nëse për shkak të transferimit të titullit të pronësisë së Objektit të Qirasë Financiare, nuk ka patur ndryshime e të drejtat dhe detyrimet e tij sipas Kontratës së Qirasë Financiare.

22. AFATI DHE KONTRATA E QIRASË FINANCIARE

22.1 Afati i Kontratës së Qirasë Financiare do të përcaktohet në Kontratën e Qirasë Financiare ku afati i kontraktuar nuk mund të jetë më i vogël se minimumi ligjor.

23. MBROJTJA DHE PËRPUNIMI I TË DHËNAVE PERSONALE

23.1 I gjithë përpunimi i të dhënave personale në kuadër të zbatimit të Kontratës së Qirasë Financiare do të bëhet në përputhje me Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe Ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për Bankat në Republikën e Shqipërisë”, Qiramarrësi në mënyrë të parevokueshme autorizon Qiradhënësin të transferojë dhe të trajtojë të gjitha të dhënat personale dhe financiare të tij tek Shoqëria Mëmë e saj, nëse dhe sa herë që kërkohet nga Shoqëritë Mëmë, në rast se përmbushen të gjitha kërkesat ligjore dhe nënligjore për transferimin e të dhënave personale jashtë shtetit ku operon Qiradhënësi. Qiradhënësi garanton, se transferimet do të realizohen vetëm nëse janë marrë të gjitha masat e nevojshme për trajtimin e sigurt të të dhënave të Qiramarrësit duke kuptuar se të dhënat e tij personale dhe financiare, do të trajtohen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi për mbrojtjen e

të dhënave personale, sekretin bankar dhe profesional.

24. HYRJA NË FUQI

- 24.1 Në ditën e nënshkrimit të Kontratës së Qirasë Financiare, ku AKP janë pjesë përbërëse e saj, Qiramarrësi merr përsipër të gjitha të drejtat dhe përgjegjësitë, që mund të lindin nga Kontrata e Qirasë Financiare.
- 24.2 Për Qiradhënësin, Kontrata e Qirasë Financiare, hyn në fuqi me përmbushjen e afateve dhe kushteve të mëposhtëm nga Qiramarrësi:
- nënshkrimi i Kontratës së Qirasë Financiare
 - kryerja e pagesës së parapagimit , komisionit të administrimit dhe këstit të parë
 - kryerja e pagesës së sigurimit të automjetit

25. DISPOZITA TË FUNDIT

- 25.1 Qiramarrësi nëpërmjet nënshkrimit të kësaj kontratë deklaron se : (i) se i gjithë informacioni i dhënë prej tij është i saktë dhe i plotë, si dhe (ii) duke kuptuar se, të dhënat demografike dhe financiare të ruajtura në Regjistrin e Kredive të Bankës së Shqipërisë do të trajtohen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, sekretin bankar si dhe sekretin profesional.
- 25.2 Në rast se ndonjë prej dispozitave të Kontratës së Qirasë Financiare është e pavlefshme, pavlefshmëria e tyre nuk do të prekë/cënoje vlefshmërinë e Kontratës së Qirasë Financiare në tërësi. Në një rast të tillë, palët do të zevendësojnë dispozitën e pavlefshme me një dispozitë të re e cila përputhet me objektin dhe qëllimin e Kontratës së Qirasë Financiare.
- 25.3 Në rast mospërputhje midis parashikimeve të Kontratës së Qirasë Financiare dhe parashikimeve të këtyre AKP, parashikimet e Kontratës së Qirasë Financiare do të kenë përparësi.
- 25.4 Të gjitha ndryshimet e Kontratës së Qirasë Financiare, do të bëhen me shkrim, formë e cila përbën një kusht për vlefshmërinë e tyre. Rregullimet e shumës së parapaguar, shumës së Këstit të Qirasë Financiare dhe pagesave të tjera sipas Kontratës së Qirasë Financiare për shkak të ndryshimit të afateve/kushteve të pagesave, afateve dhe kushteve të ri-financimit, normës së interesit etj, nuk do të konsiderohen ndryshime të Kontratës së Qirasë Financiare dhe miratimi i Qiramarrësit, nuk do të jetë i nevojshëm për këto rregullime, deri në masën e lejuar nga Legjislacioni në fuqi.

QIRAMARRËSI

QIRADHËNËSI

DORËZANËSI/T